



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi Bordi

VENDIM

Nr. 146 Datë 25.06.2018

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË
FURNIZUAR NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN
QERSHOR 2018**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 86, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017, nenit 15 të “Rregullores për Organizimi, Funksonimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.06.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin qershor 2018,

Konstatoi se:

- OSHEE sh.a., me anë të shkresës Nr. 11930 Prot., datë 11.06.2018, paraqiti në ERE aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin Qershor 2018.
- Nga analiza që i'u bë aplikimit të OSHEE sh.a. mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, rezulton se sipas llogaritjeve të OSHEE sh.a çmimi për muajin qershor 2018, është 9,82 lekë/kWh.

Edhe në aplikimin e çmimit të FMF për muajin qershor 2018 vërehen të njëjtat dukuri sikurse konstatuar edhe për periudhën janar-maj 2018. OSHEE sh.a. nuk ka mundur të alokojë shpenzimet administrative për aktivitetin e FMF .Kjo praktikë mund të rezultojë

- në favorizim të klientëve të FMF nëpërmjet transferimit të kostove të tyre tek kostot e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët e tjerë fundorë që furnizohen nga FSHU. Rrjedhimisht, u konstatua se, me përjashtim të muajit janar 2018, kostot e raportuara nga OSHE/FMF përgjatë periudhës janar- maj rezultuan më të ulta se sa çmimet me pakicë për klientët fundorë të furnizuar në atë nivel tensioni nga FSHU , kur këto çmime me pakicë kanë përfaqësuar kostot reale të shërbimit të Shoqërisë.
- OSHEE sh.a nuk ka llogaritur dhe faturuar kostot e disbalancave për klientët e FMF, veprim i cili duhet të vazhdojë të kryhet nga FSHU si detyrim ky i përcaktuar në rregullat e tregut dhe rregulloren e disbalancave si dhe siç është përcaktuar në nenin 6 të metodologjisë.
- Nga verifikimi i informacionit dhe përlllogaritjeve të paraqitura nga shoqëria rezulton një çmim prej 9.82 lek/kWh, pra më i madh se çmimi “dyscheme” 9.5 leke/kWh. Rrjedhimisht çmimi i FMF për muajin qershor 2018 propozohet të jete çmimi 9.82 lek/kWh, (në mungesë të një çmimi referues të ndryshëm nga ai prej 9,5 leke/kwh)

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë çmimin e shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 9.82 lekë/kWh për muajin qershor 2018.
2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.